

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT TIRANË**  
**Nr. 22438/2**

**VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM**

Sot, më datë 26 shtator 2001, unë 6. Bajri, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga Z. Georgios Papageorgiou dhe Z. Dimitris Gavriil në cilësinë e Administratorëve të Shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK, për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë,

**KONSTATOVA SE:**

Shoqëria "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK është person juridik i së drejtës shqiptare e regjistruar me Vendimin Nr. 22438, datë 15 dhjetor 1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe ka për Ortak të Vetëm shoqërinë "GLOBAL PETROLEUM ALBANIA" SHA.  
Me vendimin e datës 29 gusht 2001, të Mbledhjes së Asamblesë se Ortakut të Vetëm, shoqërisë "GLOBAL PETROLEUM ALBANIA" SHA, është vendosur:

- Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK me një vlerë totale prej 2,440,000 USD (dy milionë e katër qind e dyzetë mijë dollarë amerikanë) që i korrespondon shuma në lekë 350,811,000 (treqind e pesëdhjetë milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë lekë) duke emetuar pjesë kapitali të nënshkruara dhe të shlyera me të holla në dorë sipas kushteve të mëposhtëme:
  - a) Pjesët e kapitalit do të emetojen me një vlerë nominale prej 1000 lekë secila.
  - b) GLOBAL PETROLEUM ALBANIA SHA. do të kontribuojë me 100 për qind të rritjes së përgjithshme të kapitalit, d.m.th. do të paguajë 2,440,000 USD (dy milionë e katër qind e dyzetë mijë dollarë amerikanë) që i korrespondon shuma në lekë 350,811,000 (treqind e pesëdhjetë milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë lekë).
- Ortaku i Vetëm do të rrisë kapitalin me shumën e sipërpërmendor në disa faza duke paguar pjesë të shumës së përgjithshme prej 2,440,000 USD (dy milionë e katër qind e dyzetë mijë dollarë amerikanë).Në fazën e parë, Ortaku i Vetëm do të kontribuojë me shumën 700.000 USD (shtatëqind mijë dollarë amerikanë) që i korrespondon shuma në lekë 100.642.500 (njëqind milionë e gjashtëqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind lekë).
- Shumat e shprehura në dollarë amerikanë të rritjes së kapitalit do të konvertohen në Lekë sipas kursit të ditës së mbledhjes së Asamblesë (29 gusht 2001) ku 1 USD = 143,775 Lekë. Të gjitha llogaritjet do të bëhen duke marrë parasysh kursin e treguar të këmbimit të monedhës.

Pagesa nga ana e Ortakut të Vetëm "GLOABL PETROLEUM ALBANIA" SHA të shumës së mësipërme vërtetohet nga Certifikata e lëshuar nga Alpha Bank, Dega e Tiranës më datë 17 shtator 2001.

## PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e cmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",

## VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;
- Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK të datës 29 gusht 2001 ku është vendosur:
- 1. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK me një vlerë totale prej 2,440,000 USD (dy milionë e katër qind e dyzetë mijë dollarë amerikanë) që i korrespondon shuma në lekë 350,811,000 (treqind e pesëdhjetë milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë lekë) duke emetuar pjesë kapitali të nënshkruara dhe të shlyera me të holla në dorë sipas kushteve të mëposhtëme:
  - a) Pjesët e kapitalit do të emetojen me një vlerë nominale prej 1000 lekë secila.
  - b) GLOBAL PETROLEUM ALBANIA SHA. do të kontribuojë me 100 për qind të rritjes së përgjithshme të kapitalit, d.m.th. do të paguajë 2,440,000 USD (dy milionë e katër qind e dyzetë mijë dollarë amerikanë) që i korrespondon shuma në lekë 350,811,000 (treqind e pesëdhjetë milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë lekë).
- 2. Ortaku i Vetëm do të rrisë kapitalin me shumën e sipërpërmendor në disa faza duke paguar pjesë të shumës së përgjithshme prej 2,440,000 USD (dy milionë e katër qind e dyzetë mijë dollarë amerikanë). Në fazën e parë, Ortaku i Vetëm do të kontribuojë me shumën 700.000 USD (shtatëqind mijë dollarë amerikanë) që i korrespondon shuma në lekë 100.642.500 (njëqind milionë e gjashtëqind e dy mijë e pesëqind lekë).
- 3. Shumat e shprehura në dollarë amerikanë të rritjes së kapitalit do të konvertohen në Lekë sipas kursit të ditës së mbledhjes së Asamblesë (29 gusht 2001) ku  $1 \text{ USD} = 143,775 \text{ Lekë}$ . Të gjitha llogaritjet do të bëhen duke marrë parasysh kursin e treguar të këmbimit të monedhës.

Pagesa nga ana e Ortakut të Vetëm "GLOABL PETROLEUM ALBANIA" SHA të shumës së mësipërme vërtetohet nga Certifikata e lëshuar nga Alpha Bank, Dega e Tiranës më datë 17 shtator 2001.

- Urdhërohet zyra e Regjistrit Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE